



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2, nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6, dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 08.06.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **Znj. Bardha Gashi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Suharekë, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës" AAK", duke e zëvendësuar anëtaren e Kuvendit Komunal znj. Besa Kuqi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që ky vendim t'i komunikohet znj. Bardha Gashi, dhe të ndërmerrën veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 28.05.2020, Nr.5032020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Besa Kuqi pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës për arsye të emërimit në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në Komunën e Suharekës.

Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rënditur, e cila është znj. Bardha Gashi, e cila ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik dhe e njëjta gjini, dhe me numër më të madhë të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I dhe II të këtij vendimi.

- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 08.06.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

